



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES
AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Lënda: LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR KËRKESAT PËR LICENCË PROFESIONALE PËR SHOQËRI ARKEOLOGJIKE, PËR VEPRIMTARI ARKEOLOGJIKE A1, A2, B1, B2, C,

Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

1. Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum Vitae) e drejtuesit ligjor të shoqërisë apo përfaqësuesit juridik të tij, me të dhëna kryesore të drejtuesit ligjor e teknik të shoqërisë:
 - a) Emri, atësia, mbiemri, kopje e kartës së identitetit, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit i drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqërisë.
 - b) Veprimtaria që do të kryejë shoqëria, sipas kategorive dhe llojeve të përcaktuara në licencën profesionale të drejtuesit teknik për veprimtari arkeologjike.
2. **Pagesa e tarifës së aplikimit** miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
3. **Licenca e drejtuesit teknik** (A1/ A2, / B1/ B2, / C, kopje) **Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik**, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).
4. **Kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit** (dokument i jo më parë se 1 muaj nga aplikimi).
5. **Vetëdeklarim i drejtuesit ligjor** mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e shoqërisë të gjitha ligjet në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore dhe **Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë** mbi:
 - a) gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;
 - b) se nuk është drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
 - c) se nuk është në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura;
 - d) se do të zbatojë në veprimtarinë e shoqërisë, parimet e kërkimit arkeologjik, rregullat e sigurimit teknik në punë dhe aktet ligjore e nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore.
6. **Vetëdeklarim i drejtuesit ligjor se disponon ambiente të sigurta** të mbrojtura 24 orë, apo të survejuara nga kamera sigurie, për depozitimin e gjetjeve të luajtshme arkeologjike, shoqëruar me foto të këtyre ambienteve.

Shënim

Në rast të paraqitjes së koncepteve për ndërhyrjet arkeologjike, pjesë të dokumentacionit të nevojshëm është përbërja e grupit të punës.

Në grupin e punës duhet të përfshihen domosdoshmërisht, përveç arkeologëve të diplomuar në fushat e përmendura në Nenin 13, edhe:

- a) një arkeolog-konservues/konservues, i cili duhet të jetë i pajisur me Diplomë shkolle pasuniversitare (master shkencor) për arkeologjinë brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në arkeologji dhe nëndegët e saj, si dhe të ketë eksperiencë, ose të ketë kryer specializime që lidhen me konservimin arkeologjik;
- b) gjeoded
- c) skicograf;
- d) arkitekt;